

**AKT THEMELIMI DHE STATUT**  
**“HEMAL MANPOWER SUPPLY ALBANIA” SH.P.K.**

Në këtë Akt Themelimi dhe Statut

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
- “Akt Themelimi Statuti ” është Akt themelimi dhe Statuti i shoqërisë;

**Kreu I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

**Neni 1:**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

(1) Sot, me datë 28/05/2024, Unë themeluesi: **Z. SHAKYAT HOSSAIN** kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin:  
**“HEMAL MANPOWER SUPPLY ALBANIA” SH.P.K.**

(2) Themelues i shoqërisë është:

**Z. SHAKYAT HOSSAIN**, me atësi Mohammad Shah Alam dhe amësi Mamataz Begum, i datëlindjes 19.02.1971, lindur në Dhaka, Bangladesh dhe banues në Dhaka, mbajtës i pasaportës me numër B00014120 dhe ID numër personal 4623951821 dhe, me zotësi të plotë juridike, me adresë personale elektronike: [shakyat.hrel@gmail.com](mailto:shakyat.hrel@gmail.com) dhe numër kontakti personal: +355684589836.

**Objekti**

Shoqëria **“HEMAL MANPOWER SUPPLY ALBANIA” SH.P.K** do të kryejë shërbimet si vijojnë:

- Agjensi Punësimi:** Ofrime nëpërmjet ndërmjetësimit të kontratave të punës për punëkërkues shqiptar dhe të huaj për llogari të subjekteve shqiptare dhe të huaja si brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ashtu edhe jashtë saj; Ofrim i stafit teknik shqiptar dhe të huaj, të kualifikuar sipas kërkësave të tregut për llogari të të tretëve; Ofrim i shërbimit të asistencës teknike për aplikimet për leje punë dhe leje qëndrimi për shtetas të huaj; Asistence të përhershme për klientët e saj në plotësimin e dokumentacionit dhe riaplikimet për kontrata pune, leje pune, leje qëndrimi dhe çdo aplikim të kërkuar pranë institucioneve për shtetasit e huaj për qëllime pune në Republikën e Shqipërisë; si dhe çdo aktivitet tjeter që lidhet me këtë objekt, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi etj.;



- 2. Import - Eksport dhe tregëti me shumicë dhe pakicë:** Tregëti me shumicë dhe pakicë të artikujve të ndryshëm si edhe importimin dhe eksportimin e tyre; Import - eksport të produkteve ushqimore dhe mallrave industriale, materiale ndërtimi, prodhime bujqësore e blegtorale dhe nënprodukte të tyre; fruta – perime; pije të ndryshme, paisjet e kuzhinës të të gjitha kategorive si për përdorim familjar ashtu edhe për biznese; paisje elektronike, hidraulike dhe elektrike, pjesë këmbimi, vegla pune, etj. tregtimin e tyre me shumicë e pakicë si dhe transport mallrash; Import - eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të: produkteve ushqimore bazë, nënprodukte dhe përbërës të tyre dhe pijeve te ndryshme; Tregëtim të mallrave, materialeve, automjeteve, mjeteve industriale; makinerive, pajisjeve dhe impjanteve të ndryshme të karakterit industrial, bujqësor, tregtar, kulturor, sportiv, shërbimeve, etj; si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik.; si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- 3. Import – Export dhe Tregëti me Shumicë dhe Pakicë të Veshjeve:**  
Importimin dhe Exportimin e Veshjeve dhe Këpucëve dhe Aksesoreve të ndryshëm të veshjes: për fëmijë, femra, meshkuj të të gjithë gamës së Industrisë së veshjeve dhe këpucëve, sëbashku me aksesorë të ndryshëm, si brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë;  
Import dhe Export të prodhimeve të textileve për përdorime të ndryshme, duke mos u limituar në gamën e tregëtimit të tyre si për përdorime personale, familjare, shtëpie, baresh, hotelesh, kompanish private, Institucionë Publike, shkolla, etj. tregtimin e tyre me shumicë e pakicë si dhe transportin e mallrave;
- 4. Agjensi Imobiliare:** Ndërmjetësim në shitblerje dhe dhënie me qira pronash te paluajtshme për banim apo zhvillim të bizneseve të ndryshme për klientë të huaj dhe shqiptarë; Shoqëria mund të kryejë çdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme; çdo aktivitet tregtar, financiar, qira/leasing, hipotekim ose pengljenie për llogari të klientëve individë dhe kompani të huaja dhe shqiptare; Konsulenca të ndryshme dhe asistencë lidhur me pronat, për shitjen, blerjen, dhënien apo marrjen me qira si dhe rivlerësimin e tyre, në Shqipëri apo jashtë saj për klientë të huaj apo shqiptarë;

Si dhe çdo veprimtari që veçmas ose sëbashku me ato të përmendura më sipër do të konsiderohet e përshtatshme dhe me leverdi për rritjen dhe zhvillimin e aktivitetit ekonomik të Shoqërisë në përputhje me Ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çdo lloj aktiviteti lidhur me objektin e saj, të parashikuar nga ligji në përputhje me rregullat dhe dispozitat në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në bazë të autorizimeve dhe/ose lejeve përkatëse të lëshuara nga organet kompetente të fushës.



**Neni 3:**  
**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

**Neni 4:**  
**Selia**

- 1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Haxhi Hysen Dalliu", Nd. Nr. 10, Nr. 1, Njësia Administrative Nr. 9; 1016; Tiranë.
- 2) Gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj, shoqëria mund të hapë filiale, degë dhe zyra përfaqësimi në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.
- 3) Adresa elektronike e shoqërisë për qëllim të komunikimeve elektronike është [hemal.manpowersupplyalbania@gmail.com](mailto:hemal.manpowersupplyalbania@gmail.com)

**Kreu II**

**Kapitali**

**Neni 5**

**Kapitali themeltar**

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100'000 (një qind mijë) Lekë. Pjesëmarria e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e saj si më poshtë vijon:

1. Ortaku themelues Z. **SHAKYAT HOSSAIN** zoteron 1 (një) kuotë me vlerë të përgjithshme 100'000 (njëqindmijë) Lekë që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

**Neni 6**

**Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para/monedhë të huaj dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

**Neni 7**

**Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;

- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### **KREU III ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 8**

##### **Organ Vendimmarrës**

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.


Asambleja e Përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë; si edhe hapjen dhe regjistrimin e filialeve, degëve dhe/ose zyrave të përfaqësimit brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- h) miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshinë edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.



## **Neni 9**

### **Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

- a) Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë dhe/ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- b) Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas shkronjës "a" të këtij nenit përsye urgjente dhe/ose të jashtëzakonshme në lidhje me vendimmarrje të emergjente për shoqërinë, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht mënyrës jo të zakonshme të mënyrës së thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të përcaktuar në shkronjës "a" të këtij nenit.
- c) Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të zhvillohet dhe online nëpërmjet internetit dhe vendimet e tjera nënshkruhen në mënyrë elektronike.

## **Neni 10**

### **Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 50 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas Nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur më lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.


## **Neni 11**

### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruar të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;



f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;  
Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

## Neni 12

### Përjashtimi nga e drejta e votës

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënen ose jo të përfitimeve të reja.

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

## Neni 13

### Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet (pesë vjet) nga data 28.05.2024, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratori i shoqërisë tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personi i mëposhtëm caktohen si Administrator i Parë i Shoqërisë deri në emërimin e tij nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

### Të dhënat e identifikimit të Administratorit:

**Z. SHAKYAT HOSSAIN**, me atësi Mohammad Shah Alam dhe amësi Mamataz Begum, i datëlindjes 19.02.1971, lindur në Dhaka, Bangladesh dhe banues në Dhaka, mbajtës i pasaportës me numër B00014120 dhe ID numër personal 4623951821 dhe, me zotësi të plotë juridike, me adresë personale elektronike: [shakyat.hrel@gmail.com](mailto:shakyat.hrel@gmail.com) dhe numër kontakti personal: +355684589836.

## Neni 14

### Kompetencat e Administratorëve

1) Administratori ka të drejtë e detyrohet:

- a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;



- c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullit të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) të përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) të kryejë regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

2) Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

1. sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
2. shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
3. shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

3) Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator për shoqërinë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ata e administrojnë sëbashku shoqërinë.

Në rastet e regjistrimin të filialeve, degëve dhe/ose zyrave të përfaqësimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, administratorët e administrojnë shoqërinë për territorin e shtetit në të cilin janë emëruar si administratorë.


4) Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## **Neni 15**

### **Përgjegjësitet e Administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.



Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesht;
  - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, është i detyruar t'i dëmshpërbujejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare duke vlerësuar shkallën e dëmit/dëmeve dhe pasojës/pasoja.
4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërbujejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme:
- a) u kthen ortakëve kontributet;
  - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
  - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikojë që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
  - d) jep kredi.
- Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërbimin financier, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.



## **Kreu IV**

### **Viti finansiar - Ekspertët**

#### **Neni 16**

##### **Viti Financiar**

Viti finansiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë finansiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërise në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllt me 31 Dhjetor.

#### **Neni 17**

##### **Ekspertët**

Eksperti ka per detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finansiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'i paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

## **Kreu V**

### **Prishja – Riorganizimi i shoqërisë**

#### **Neni 18**

##### **Prishja dhe likuidimi**


Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të Gjykatës;

Në këtë rast, Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 (një) apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.



## **Neni 19**

### **Degët dhe zyrat e përfaqësimit**

#### **Riorganizmi i shoqërisë bashkimi – ndarja**

Shoqëria mund të krijojë dhe regjistrojë degët/filiale dhe zyrat e saj të përfaqësimit brenda territorit të Republikës së Shqipërise dhe jashtë saj, sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

## **Neni 20**

### **Baza Ligjore**

Shoqeria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.  
Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

## **Neni 21**

### **Gjuha e përdorur**

Gjuha e përdorur në Akt themelimin dhe Statutin e shoqërisë u hartuar në gjuhën Shqipe.



**Neni 22**

**Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

**TIRANË, MË 28/05/2024**

**ORTAKU I VETËM**

**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“HEMAL MANPOWER SUPPLY ALBANIA” SHPK**

**Z. SHAKYAT HOSSAIN**

*SHAKYAT HOSSAIN*

